



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 06/L-060

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR KUFIRIN SHETËTOROR
NË MES TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE MALIT TË ZI**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në bazë të Deklaratës së përbashkët të Presidentit të Republikës së Kosovës, Sh.T.Z. Hashim Thaçi dhe Presidentit të Malit të Zi, Sh.T.Z. Filip Vujanović të datës 16.02.2018

Miraton:

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR KUFIRIN
SHETËTOROR NË MES TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE MALIT
TË ZI**

Neni 1

Ratifikohet Marrëveshja për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, e nënshkruar në Vjenë me datë 26 gusht 2015.

Neni 2

Dispozitat e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, e nënshkruar në Vjenë me datë 26 gusht 2015, nëse ka fakte të reja ligjore, mund të ndryshohen dhe plotësohen me pëlqimin e palëve. Dispozitat e kësaj marrëveshje mund të ndryshohen sipas procedurës së njëjtë të paraparë për miratim. Me pajtimin e palëve, për ndryshimin e dispozitave të marrëveshjes mund të kërkohet edhe Arbitrazh ndërkombëtar.

Neni 3

1. Pjesë përbërëse e këtij ligji janë:

1.1. Marrëveshja për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, e nënshkruar në Vjenë me datë 26 gusht 2015;

1.2. Deklarata e përbashkët e Presidentit të Republikës së Kosovës, Sh.T.Z. Hashim Thaçi dhe Presidentit të Malit të Zi, Sh.T.Z. Filip Vujanoviq e datës 16.02.2018;

1.3. Dokumentacioni zyrtar i Komisionit Shtetëror për shënimin e Kufirit Shtetëror - për orientim.

Neni 4 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 06/L-060
21 mars 2018

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI